

## MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË BASHKISË POGRADECPËR VITIN 2021

Për të gjithë kategoritë e tatimpaguesve dhe përfituesve të shërbimeve publike, të ofruara në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Prrenjas: 1. nivelin e taksave dhe tarifave vendore , 2. afatet e pagesës, 3. përjashtimet e lehtësirat fiskale për çdo kategori përfituese , 4. strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre , 5. të drejten e ankimit për çdo vlerësim , 6. arsyen e vendosjes së penaliteteteve/ gjobave për kundravajtjen e shkaktuara nga tatimpaguesit , 7. nivelin e tyre për çdo kundravajtje si dhe 8. strukturat e ngarkuara për vendosjen e vjeljen e tyre.

A. TAKSAT VENDORE Ne zerin “ Taksa vendore “, konform ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Per Sistetimin e Taksave Vendore”, i ndryshuar , perfshihen llojet e tyre si me poshte :

1. Taksa Taksa e Biznesit te vogel (Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin ).
2. Taksa mbi pasurine e paluajtshme a.Taksa mbi ndertesen, b.Taksa mbi token bujqesore, c.Taksa mbi truallin,
3. Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per Pasurite e Paluajtshme.
4. Taksa e ndertimit ne infrastrukture per Dertimet e Reja
5. Taksa e tabelës
6. Taksa e regjistrimit te përvitshem te automjeteve te transportit rrugor
7. Taksa e fjetjes ne hotel
8. Taksa te perkohshme

### B. TARIFAT VENDORE

Llojet e tarifave subjekt i ketij vendimi jane :

1. Tarifa Pastrimi
2. Tarifa Ndricimi
3. Tarifa Gjelberimi
4. Tarifa Parkimi dhe pajisje me leje transporti
5. Tarifa ne sektorin e ndertimit dhe zhvillimit te teritorit
6. Tarifa per dhenien e licencave (autorizimeve ) ne tregtim te karburanteve

## 7. Tarifa per zenien e hapsires publike

## 8. Tarifa per sherbime administrative Ne baze te nenit 35 te ligjit 9632 dt. 30.10.2006

Bashkia krijon te ardhura nga tarifat vendore per: Sherbime publike qe ato afrojne (pastrim, gjelberim, ndricim, etj.) | Te drejten e perdorimit te pronave publike vendore (psh, tarife parkimi, tarifa perdorimi te shesheve vendore etj.)

Dhenia e licencave, lejeve, autorizimeve, leshimi i dokumentave etj. Ne pergjithesi tarifat e sherbimeve percaktohen me synimin mbulimin e kostove te tyre. Me vendosjen e tarifave nga Bashkia kemi ne konsiderate vendosjen ne lidhje te drejperdrejte midis tarifes dhe qellimit te perdorimit te saj, me synimin qe qytetaret te ndergjegjesohen dhe te ndejne efektin e pageses se bere prej tyre.

Percaktimi i tarifes do te shoqerohet me publikim dhe njoftim qe personat, familjaret apo subjektet te njihen ne kohen e duhur. Tarifat per pastrim, gjelberim dhe ndricim jane detyrime vjetore te tatimpaguesit ekzistues dhe per ata qe regjistrohen rishtaz per periudhen e mbetur deri ne fund te vitit ushtrimor.

Për vendosjen e tarifave vendore (pastrim , ndriçim, gjelbërim) do të bëhet vlerësimi nga zyra, qe bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, situatën e tatimpaguesve të tjerë të ngjashëm, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.